



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

NR I VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/R/145/2012
29/02/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 18 (tetëmbëdhjetë) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe C të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.

(2) Në secilën prej 8 (tetë) kërkesave të identifikuara në pjesën C të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet; dhe

(3) Në kërkesat me nr. 14101, 22487, 24611, 40044, 43192, 49461 dhe 54791 të referua në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të

Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹.

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e shtatë nga 27 deri 29 shkurt 2012 në Prishtinë. Gjithsej i janë paraqitur Komisionit 160 kërkesa për pronë banesore në seancën e njëzetë e shtatë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. 27 kërkesa për pronë banesore të cilat i ishin paraqitur Komisionit iu kthyen Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për verifikim të mëtejshëm. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e një kërkesave banesore në pritje të mbajtjes së seancave dëgjimore. Gjithsej 132 kërkesa për pronë banesore janë vendosur nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës..

A. Kërkesat të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, me përjashtim të kërkesës nr. 14101, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat banesore, përfshirë tokën e bashkuar. Në kërkesën nr. 14101 paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit.

8. Ky vendim përfshin 26 kërkesa për pronë banesore të cilat janë të shënuar në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 106 kërkesave për pronë banesore përfshihen në vendimet KPCC/D/R/143/2012 dhe KPCC/D/R/144/2012.

9. Gjithsej 24 nga 26 kërkesa të përfshira në këtë vendim janë vendosur më herët nga Komisioni, ndërsa kërkesat me nr. 54480 dhe 54498 kanë qenë subjekt i vendimit të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimet e mëparshme për këtë dy kërkesa janë shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronës së kërkuar gjatë përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive. Për rrjedhojë këto dy kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar. Çfarëdo dëshmi apo informacion i ri i ofruar nga palët përgjegjëse në kërkesa ose uzurpuesit aktualë të pronave të kërkuara do të merret në konsideratë nga Komisioni gjatë rivendosjes së kërkesës. Në kërkesat vendimet e të cilave janë shfuqizuar nga Komisioni Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar atë për gabimet e

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksat e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksat e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksat e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksat I, II dhe III, respektivisht.

notifikimit dhe e ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet e kadastrave përkatëse janë informuar se vendimi i mëparshëm të Komisionit është pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Të tetëmbëdhjetë kërkesat e shënuara në pjesët B dhe C të listës së bashkangjitur janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose një palë që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

11. Të tetë kërkesat e shënuara në pjesën A të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Vendimet që janë marrë në kërkesat që janë notifikuar pasaktësisht janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë të pronave dhe për t'i ofruar cilitdo person që mund të ketë interes ligjor në pronë, me mundësinë për të dhënë përgjigje për kërkesën në pajtim me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse të listës së bashkangjitur këtij vendimi. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë.

12. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

13. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

14. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.).

15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për pronën e kërkuar.

16. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

1. *Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit.*

a. *Kërkesa nr. 11751*

17. Kërkesa nr. 11751 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë dhurimi të vitit 1990 nga vjehri i saj, që i jep ½ e pjesës ideale të pronës së kërkuar djalit të tij, mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive e ka konstatuar kontratën si të vërtetë.

18. Pala përgjegjëse, i cili është vëllai i mbajtësit të së drejtës pronësore dhe aktualisht po e shfrytëzon pronën e kërkuar, i kontestoi pretendimet e paraqitësit të

kërkesës duke pohuar se ai është i vetmi trashëgimtar në bazë të kontratës së dhurimit të bërë në vitin 1993 midis tij edhe babait të tij. Sekretaria Ekzekutive e verifikoi kontratën si të vërtetë.

19. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitësit të kërkesës ka lindur nga një kontest paraprak familjar dhe jo nga konflikti i vitit 1998-99. Rrjedhimisht, në mungesë të humbjes së posedimit ose kontrollit për pronën e kërkuar si rezultat i konfliktit 1998-99, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

b. Kërkesë nr. 22487

20. Kërkesa nr. 22487 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon kompensimin për shtëpinë e shkatërruar duke pohuar se shtëpia është shkatërruar nga pala përgjegjëse.

21. Pala përgjegjëse, i cili aktualisht ka uzurpuar pronën, pohon se e shfrytëzon pronën me lejen e Komunës. Ai ka paraqitur një fletë poseduese që tregon se prona e kërkuar është në pronësi të komunës. Sekretaria Ekzekutive e verifikoi fletën poseduese si të vërtetë.

22. Pasi kërkesa e paraqitësit të kërkesës është vetëm për kompensim e pronës së shkatërruar, ajo bie jashtë mandatit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

c. Kërkesat nr. 54480 dhe 54498.

23. Kërkesat nr. 54480 dhe 54498 janë depozituar nga dy paraqitës të ndryshëm të kërkesave, vëlla e motër, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tyre. Kërkesat kanë të bëjnë me dy prona të ndryshme. Paraqitësit e kërkesave deklarojnë se familja e tyre u largua nga pronat më 1995-96 kur ata u vendosën në Arandjelovac në Serbi. Paraqitësit e kërkesave pranojnë se ndonëse situata në atë kohë në Kosovë nuk ishte e mirë, ndaj tyre nuk u ushtrua asnjë trusni për t'u larguar nga Kosova. Paraqitësit e kërkesave kanë vazhduar të jetojnë në Serbi qysh atëherë. Pronat e kërkuara ndodhen në komunën e Zveçanit, zonë me shumicë serbe.

24. Pasi paraqitësit e kërkesave e pranojnë vetë se kërkesat e tyre nuk kanë lindur nga konflikti i 1998-99. Rrjedhimisht ato bien jashtë mandatit të Komisionit edhe duhet të hidhen poshtë.

2. Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së autorizimit.

25. Kërkesa nr. 40044 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vjehrrit të saj. Paraqitësi i kërkesës nuk ka ofruar autorizim nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ose nga një anëtar i bashkësisë familjare të tij. Ndonëse paraqitësi i kërkesës tregoi se do të ofronte autorizimin e kërkuar, ajo dështoi ta bëjë këtë.

26. Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë të plotë në pajtim me procedurën e përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

3. Tjetërsimi vullnetar ose mundësia për të ushtruar të drejtën pronësore.

27. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, fillimisht paraqitësit e kërkesave pretenduan se familje e tyre i humbën pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit të vitit 1998-1999. Megjithatë, me vonë, paraqitësi i kërkesave e informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata ose familjet e tyre sipas rastit, i tjetërsuan pronat vullnetarisht. Fakti që paraqitësit e kërkesave ose mbajtësit e së drejtës pronësore sipas rastit, kanë pasur mundësi të shesin pronat e kërkuara tregon se ata kanë qenë në situatë të ushtrojnë të drejtat pronësore në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

28. Kërkesa nr. 36889 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortes së tij. Gjatë një bisede telefonike me Sekretarinë Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës deklaroi se bashkëshortja e tij u largua nga prona në vitin 1968 dhe u vendos në fshatin Koretiste ku jetoi deri më 17 qershor 1999. Prona e kërkuar ndodhet në fshatin Bezimeni. Në qershor 1999 ajo u vendos në Bujanovac, Serbi për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë. Pala përgjegjëse deklaroi se e ka blerë pronën nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në prill 2011. Paraqitësi i kërkesës e konfirmoi shitjen e pronës tek pala përgjegjëse, megjithatë ai dëshiron të vazhdojë me kërkesën sepse pala përgjegjëse nuk e ka paguar çmimin e plotë të blerjes. Komisioni vëren se ai nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla.

29. Në kërkesën nr. 11654, paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në formularin e pranimit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës deklaroi se e kishte humbur posedimin e pronës së kërkuar në prill 2005. Gjatë përpunimit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se e kishte shitur pronën dhe se nuk dëshironte të kontaktohej më tej nga AKP-ja. Megjithatë, ajo nuk e tërhoqi kërkesën.

30. Kërkesa nr. 21890 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Pala përgjegjëse pohon se e ka blerë pronën e pretenduar nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në vitin 2009. Më pas, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se babai i tij në të vërtetë e kishte shitur pronën e kërkuar por se ai nuk ishte i kënaqur me çmimin e blerjes. Komisioni vëren se ai nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla.

31. Në kërkesën nr. 27581 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djalit të saj. Paraqitësi i kërkesës me pas konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur më 2008 dhe se do ta tërhiqte kërkesën, megjithatë ajo dështoi ta bëjë këtë.

32. Në kërkesën nr. 33512 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës me pas konfirmoi se e kishte

shitur pronën në vitin 2007. Paraqitësi i kërkesës tregoi se do ta tërhiqte kërkesën, por dështoi ta bëjë këtë.

33. Në kërkesat nr. 43191 & 43192 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës me pas konfirmoi se babai i tij e kishte shitur pronat e kërkuara pas konfliktit dhe ndërkohe vdiq. Paraqitësi i kërkesës tregoi se do ta tërhiqte kërkesën, por dështoi ta bëjë këtë.

34. Në kërkesën nr. 44653 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës me pas konfirmoi se ia kishte shitur palës përgjegjëse pronën e kërkuar më 2006 ose 2007. Kërkesa nuk është tërhequr.

35. Në kërkesën nr. 49641 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës me pas konfirmoi se e kishte shitur pronën e kërkuar në vitin 2008. Ai nuk e tërhoqi kërkesën por konfirmoi se dëshiron që kërkesa të hidhet poshtë.

36. Në kërkesën nr. 53112 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pohon se e ka blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2000. Më pas, paraqitësi i kërkesës pranoi shitjen e shtëpisë tek pala përgjegjëse, megjithatë deklaroi se dëshironte të përfshinte një parcelë tjetër në kërkesë e cila nuk i ishte shitur palës përgjegjëse. Komisioni vëren se afati ligjor për të bërë kërkesë në AKP skadoi më 3 dhjetor 2007 dhe për rrjedhojë kërkesat e reja nuk mund të pranohen pas këtij afati.

37. Në kërkesën nr. 56665 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës pohon se e kishte humbur posedimin si rezultat i konfliktit të vitit 1999. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në vitin 2005 dhe ka paraqitur si dëshmi kontratën e blerjes të lidhur më 5 shtator 2005. Sekretaria Ekzekutive e e ka verifikuar kontratën e blerjes si të vërtetë. Paraqitësi i kërkesës e mohon ta ketë shitur pronën e kërkuar duke pretenduar se dëshmia e ofruar nga pala përgjegjëse është e falsifikuar. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij dhe nuk ishte i gatshëm të bashkëpunojë me Sekretarinë Ekzekutive.

4. *Res judicata*

38. Në kërkesën nr. 38377 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka depozituar më herët kërkesë të kategorisë C për të njëjtën pronë në Drejtoratin për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB) me kërkesën nr. DS200882 dhe pala përgjegjëse e kësaj kërkesë ka paraqitur kërkesë të kategorisë A për të njëjtën pronë në DÇPB me kërkesën nr. DS005305. Më pas, Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore me vendimin nr. HPCC/D/210/2005/A&C datë 20 gusht 2005, e miratoi kërkesën e palës përgjegjëse në kërkesën nr. DS005305, duke i kthyer palës përgjegjëse të drejtën pronësore për pronën e kërkuar, ndërsa paraqitësit të kërkesës i është miratuar kompensimi në vend të riposedimit.

39. Në kërkesën nr. 44455, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka depozituar më herët kërkesë të kategorisë C për të njëjtën pronë në Drejtoratin për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB) me kërkesën nr. DS600858 dhe pala përgjegjëse e kësaj kërkesë ka paraqitur kërkesë të kategorisë A për të njëjtën pronë në DÇPB me kërkesën nr. DS606382. Më pas, KKPb-ja me vendimin nr. HPCC/D/222/2005/A&C datë 22 tetor 2005 hodhi poshtë kërkesën e paraqitësit të kërkesës nr. DS600858 dhe miratoi kërkesën e palës përgjegjëse nr. DS606382, duke i kthyer palës përgjegjëse të drejtën pronësore për pronën e kërkuar.

40. Në kërkesën nr. 48778 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka depozituar më herët kërkesë të kategorisë C për të njëjtën pronë në Drejtoratin për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB) me kërkesën nr. DS305610. Më pas, KKPb-ja me vendimin nr. HPCC/D/262/2006/A&C datë 10 shtator 2006 e hodhi poshtë kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Kontesti ishte paraqitur edhe para Gjykatës Komunale të Vitisë në vitin 2004. Gjykata Komunale ka nxjerrë një aktgjykim më 10 mars 2006 ku konfirmon të drejtën pronësore të palës përgjegjëse për pronën e kërkuar. Aktgjykimi mori formën e prerë më 30 mars 2006.

41. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mund të hedhë poshtë një kërkesë e cila është shqyrtuar dhe vendosur më herët në një vendim administrative ose gjyqësor i formës së prerë. Komisioni vëren se në pajtim me nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 vendimet e formës së prerë të KKPb-së janë të detyrueshme dhe të zbatueshme dhe nuk i nënshtrohen rishikimit nga ndonjë organ administrativ ose gjyqësor në Kosovë. Rrjedhimisht, vendimi i mëparshëm i KKPb-së në këtë çështje përbën çështje *res judicata*.

42. Komisioni konstaton se të gjitha kërkesat e përfshira në këtë seksion B duhet të hidhen poshtë për mungesë të juridiksionit për arsyet e përmendura më sipër.

C. Kërkesa të refuzuara.

43. Në bazë të nenit 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës, ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për drejtat e tyre pronësore dhe të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

44. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 të

Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

45. Kërkesa nr. 14101 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1989 dhe e ka shfrytëzuar atë deri më 1999, kur e ka humbur posedimin për shkak të konfliktit. Paraqitësi i kërkesës dështoi të paraqitë dokumente në mbështetje të kërkesës së saj. Komisioni vëren se pala përgjegjëse pohon se ai po e shfrytëzon pronën e kërkuar me lejen e Komunës, por gjithashtu ka dështuar të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij. Në mungesë të dëshmive në mbështetje të kërkesës së paraqitësit të kërkesës, ajo duhet të refuzohet.

46. Në kërkesën nr. 08306 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se a ka humbur posedimin e pronës së kërkuar më 1999 si rezultat i konfliktit. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese, megjithatë, Komisioni vëren se ajo nuk ka të bëjë me pronën e kërkuar. Pala përgjegjëse pretendon se ai e trashëgoi pronën e kërkuar nga babai i tij në vitin 1941. Në mbështetje të pretendimeve të tij, ai paraqiti fletën poseduese dhe certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme, të cilat, të dyja e tregojnë palën përgjegjëse si mbajtësin e së drejtës pronësore. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

47. Në kërkesën nr. 13247 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se e humbi posedimin në qershor 1999, kur ajo u largua nga Kosova për arsye sigurie. Megjithatë, gjatë përpunimit të kërkesave, paraqitësi i kërkesës pranoi se ajo e kishte shfrytëzuar banesën nga viti 1972 deri në vitin 1990, kur bashkëshortit të saj iu nda një banesë me e madhe në të cilën ata u vendosën. Ajo pohon se bashkëshorti i saj e bleu pronën e kërkuar në vitin 1999 dhe paraqiti kontratën e blerjes të datës 9 shkurt 1999 në lidhje me pronën e kërkuar. Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë këtë kontratë. Paraqitësi i kërkesës nuk ka mundur të shpjegojë se si bashkëshorti i saj mund ta ketë blerë një pronë shoqërore e cila ende nuk i ishte ndarë, pasi kjo ka qenë e pamundur sipas ligjit në fuqi. Pala përgjegjëse pretendon se ka të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar e cila është konfirmuar nga aktgjykimi i Gjykatës Komonale të Prishtinës i vitit 2006. Në këto rrethana kërkesa duhet të refuzohet.

48. Në kërkesën nr. 08228 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore dhe në kërkesën nr. 91973 në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht të vëllait të tij. Të dy kërkesat janë paraqitur në lidhje me të njëjtën pronë, ku në secilën kërkohet konfirmimi i pronësisë për ½ pjesë ideale të pronës. Pala përgjegjëse pretendon se babai i tij a ka blerë pronën e kërkuar nga babai i paraqitësit të kërkesës në vitin 1976

dhe se familja e tij e ka pasur atë në posedim e pashqetësuar që nga ajo kohë. Pala përgjegjëse dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij me arsyetimin se i gjithë dokumentacioni, përfshirë kontratën e blerjes ishte shkatërruar gjatë konfliktit. Gjatë seancës së 25-të më 25 tetor 2001 Komisioni caktoi një nga anëtarët e tij të mbajë një seancë dëgjimore në pajtim me nenin 5.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Seanca dëgjimore u mbajt më 7 shkurt 2012 ku morën pjesë përfaqësuesi ligjor i palës përgjegjëse dhe një dëshmitar, Petrit Hajrazi i ofruar nga paraqitësi i kërkesës. Paraqitësi i kërkesës vetë tregoi se nuk pati mundësi të marrë pjesë duke iu referuar arsyeve të sigurisë. Dëshmitari dha një dëshmi gjithëpërfshirëse mbi transaksionin e pronës ndërmjet babait të paraqitësit të kërkesës dhe vëllait të tij në njërën anë dhe babait të palës përgjegjëse në anën tjetër, ku konfirmoi se prona e kërkuar i ishte shitur babait të palës përgjegjëse nga babai i paraqitësit të kërkesës në vitet 1970. Bazuar në dëshmitë para tij, përfshirë dëshmitë verbale, të cila Komisioni i konstaton të besueshme, Komisioni arrin në përfundimin se pronësia e pronës është transferuar nga babai i paraqitësit të kërkesës tek babai i palës përgjegjëse para konfliktit. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet.

49. Në kërkesën nr. 24611 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij. Paraqitësi i kërkesës me pas, konfirmoi se e kishte shitur pronën në vitin 1982 tek pala përgjegjëse dhe se do ta tërhiqte kërkesën, por dështoi të veprojë kështu. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet

50. Në kërkesën nr. 54791 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësi të së drejtës pronësore të pronës së kërkuar. Fillimisht paraqitësi i kërkesës deklaroi se e kishte humbur posedimin e pronës së kërkuar në qershor 1999 si rezultat i konfliktit, më pas konfirmoi se e kishte shitur pronën e kërkuar në vitin 1986 tek pala përgjegjëse. Ai pohon se pala përgjegjëse nuk ia ka paguar atij çmimin e plotë të blerjes. Pala përgjegjëse e konteston kërkesën e paraqitësit të kërkesës ku deklaroi se ai i ka blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në vitin 1986 dhe i ka përmbushur të gjitha detyrimet kontraktore ndaj paraqitësit të kërkesës. Komisioni vëren se është e pakontestueshme mes palëve fakti se paraqitësi i kërkesës nuk ka pasur të drejta pronësore për pronën e kërkuar në kohën e konfliktit të 1998-99. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet. Sa i takon pohimit të paraqitësit të kërkesës së pala përgjegjëse nuk ka paguar çmimin e plotë të blerjes, Komisioni vëren se ai nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla.

D. Kërkesa për kompensim


51. Në kërkesat me nr. 14101, 22487, 24611, 40044, 43192, 49641 dhe 54791 paraqitësi i kërkesës kërkon gjithashtu, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin fizik të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

E. Vërejtje përmbledhëse

52. Nisur sa më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e shënua në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur duhet të hidhen poshtë dhe kërkesat e shënua në pjesët C të listës së bashkangjitur duhet të refuzohen dhe udhëzon të nxirret një urdhër në lidhje me secilin kërkesë ashtu si është përcaktuar më sipër.

53. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

54. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën anglez

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA43191	KPA43192	KPA54480	KPA54498	KPA11654	KPA40044	KPA27581
KPA49641						

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA11751	KPA22487	KPA36889	KPA44455	KPA44653	KPA48778	KPA21890
KPA33512	KPA38377	KPA53112				

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part C/Pjesa C/Deo C

KPA14101	KPA56665	KPA08306	KPA13247	KPA24611	KPA54791	KPA08228
KPA91973						